Si t'i shpjegosh bindjet e tua për homoseksualizmin

Kjo fletë pune do të të ndihmojë të mendosh si t'i shpjegosh bindjet e tua me takt.

«Fjala juaj të jetë gjithnjë me hir . . . që të dini se si t'i përgjigjeni gjithsecilit.»
—Kolosianëve 4:6.

1



PARA SE TË PËRGJIGJESH, MENDO:

Ndonjëherë kur njerëzit thonë se Biblës i ka ikur koha, *në të vërtetë* duan të thonë se standardet e saj ndryshojnë nga të tyret. Sipas teje, a mendon personi me të cilin po flet se u ka ikur koha *të gjitha* standardeve të Biblës—përfshirë ligjin kundër vjedhjes, tradhtisë bashkëshortore dhe vrasjes? —Romakëve 13:8-10.

Për cilat arsye mendon kështu personi?	Ç'pyetje mund t'i bësh që të kuptosh më shumë çfarë mendon ai?	Çfarë shkrimesh mund t'i lexosh?

FORMULO PËRGJIGJEN

«Standardeve të Biblës u ka ikur koha.»

«Disa mendojnë kështu. Por, unë besoj ndryshe, sepse . . . »

_____

_____

_____

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania

2

PARA SE TË PËRGJIGJESH, MENDO:

Bibla nuk thotë nëse dëshirat homoseksuale janë të trashëguara. Prandaj, në vend që të debatosh për *shkakun* e homoseksualizmit, përqendrohu te *sjellja* homoseksuale.

Gjej një krahasim. Cilat sjellje të tjera mund të jenë të rrënjosura thellë? Për shembull, Proverbat 29:22 thotë se disa janë '*njerëz* zemërakë' dhe 'nxehen *kollaj'.* Madje, apostulli Pavël tha për veten: «Kur dua të bëj atë që është e drejtë, ajo që është e keqe, është brenda meje.» (Romakëve 7: 21) A duhet të veprojmë gjithmonë sipas impulseve tona?

Për cilat arsye mendon kështu personi?	Ç'pyetje mund t'i bësh që të kuptosh më shumë çfarë mendon ai?	Çfarë shkrimesh mund t'i lexosh?

FORMULO PËRGJIGJEN

«Homoseksualët nuk ndryshojnë dot, ashtu kanë lindur.»

«Bibla nuk thotë nëse dëshirat homoseksuale janë të trashëguara. Ama *thotë* se . . . »

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania

3

«Duhet të ndryshosh mendim për homoseksualizmin.»



PARA SE TË PËRGJIGJESH, MENDO:

Mos ndoshta personi ka një shok a të afërm gej ose lezbike? A mendon ai se, kur hedh poshtë atë që *praktikon* dikush, po hedh poshtë *vetë individin?* A e *kupton* vërtet personi pikëpamjen tënde për homoseksualizmin?

Gjithashtu: A po tregohen të tjerët tolerantë nëse presin që ti të ndryshosh pikëpamje për t'iu përshtatur atyre?

Për cilat arsye mendon personi kështu?	Ç'pyetje mund t'i bësh që të kuptosh më shumë çfarë mendon ai?	Çfarë shkrimesh mund t'i lexosh?

FORMULO PËRGJIGJEN

«Duhet të ndryshosh mendim për homoseksualizmin.»

«E kuptoj pse mendon kështu. Megjithatë, . . . »

Për më shumë informacion, shih librin *Të rinjtë pyesin . . . Përgjigje praktike,* vëllimi 1, kapitulli 23 «Si ta shpjegoj pikëpamjen e Biblës për homoseksualizmin?» Librin mund ta gjesh online në sitin www.jw.org. Shih te BOTIME > LIBRA DHE BROSHURA.

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania